

## **NDËRVARSHMËRIA NË MES MASES MONETARE, ÇMIMEVE DHE AKTIVITETIT EKONOMIK.**

*Mr.sc. Mehdi Gjakova, profesori i SHLE,  
mehdigjakova@hotmail.com*

### **Abstrakti**

Ekonomia e tregut bashkëkohor është ekonomia monetare, veprimet e së cilës bëhen përmes parave dhe surrogatëve të saj . sjellja e Jdo subjekti ekonomik varet nga vëllimi, mënyra e aplikimit të formave të ndryshme të parasë - surrogatëve të saj. Këto jo vetëm për arsye se përmes parasë shprehet edhe profiti, por pikërisht bejnë shprehjen dhe sjelljet e të gjitha subjekteve ekonomike me qëllim të realizimit të të ardhurave, sigurimin e likuiditetit në procesin riprodhues, dhe siguron “fuqi” në marrëdhëniet në mes subjekteve ekonomike përmes së cilës sigurohen kushtet optimale për realizimin e rritjes, dhe zhvillimit ekonomik. Problemet në ekonomi mund të zgjidhen me definimin e parave, çmimeve dhe aktivitetit ekonomik në varshmërti të rrethanave specifike të marrëdhënieve shoqërore, dhe politikave zhvillimore, specifikat në të cilat subjektet ekonomike veprojnë. Përmes teorisë, parimeve, rregullave dhe ligjshmërive krijohen opinionet lidhur me procesin e marrjes së vendimeve për zgjidhjen e problemeve konkrete në ekonominë monetare.

**Fjalët kyqe:** masa monetare, çmimi, paraja,

**JEL klasifikimi:** G2, G21,

### **Hyrje**

Zhvillimin ekonomik e shoqërojnë faktorët të shumtë shoqëror-ekonomik, politik, social etj. të cilët përbëjnë një objektivë primare në hartimin dhe zbatimin e politikave ekonomike, duke mos lënë anash rrethanat natyrore dhe kohore në të cilat ekonomija reale tenton t'i realizon qëllimet e parashtruara.

Andaj, sistemi ekonomik dhe politika ekonomike duhet të jetë në funksion të arritjes zhvillimore që bënë parakushtin themelor në arritjen e objektivave të saja. Ekonomija aplikative përmes masave dhe instrumenteve të saja, si pjesë e ekonomisë së përgjithshme, duhet të krijojë parakushtet adekuate me qëllim të rritjes së ekuilibrit të marrëdhënieve në mes të ofertës dhe kërkesës pra faktorëve që kushtëzojnë këto ecuri.

Kuptimi i tillë i ekonomisë aplikative i shërben strukturave shoqërore në arritjen e qëllimeve zhvillimore makro-ekonomike. Mirëpo, na është e kurtë se politika ekonomike përbëhet nga nënsistemet e saja: politika monetare, politika fiskale, politika investive, politiken e punësimit dhe politiken e marrëdhënieve me vendet tjera. Të gjitha këto nënsisteme kanë rol dhe rëndësi në rritje dhe zhvillimin

ekonomik të ekonomisë kombëtare. Harmonizimi i këtyre nënsistemeve bën një nga detyrat më të rëndësishme të cilat mund të shprehen përmes rezultateve të arritura të produktit kombëtar bruto, dhe nvarshmërisë e cila kushtëzon funksionimin e ekonomisë së tregut. Pra, kjo bënë njëren nga parakushtet pa të cilat nuk mundemi t'i përgjigjemi zhvillimit harmonik dhe proqesit riprodhues i cili është mjaft i ndërlikuar dhe kërkon zgjedhjen adekuate të problemeve në të gjitha fazat e saja, duke i kushtuar vëmendje te veçan procesit të ndarjes dhe shpërndarjes të të ardhurave kombëtare dhe eliminimin të pozitave monopolistike, të cilat nuk mund të zgjidhen thjeshtë përmes funksionimit të tregut, por si modalitet i "etikes shoqërore" lidhur me sigurimin e likuiditetit në ekonomi posaqërisht të vet procesit të riprodhimit, dhe siguri "fuqisë" ekonomike si më të rëndësishëm në aspektin makroekonomik kursimi dhe investimi.

### **1. Paraja dhe ekonomia**

Mënyra se si po arrihet në realizimin e politikave makroekonomike, edhe përkundër përpjekjeve të organeve dhe institucioneve shoqërore në marrjen e masave dhe zbatueshmërinë e instrumenteve tregon qartë se pos faktorëve endogjenë, ndikim të madh kanë faktorët ekzogjen të cilët edhe përkundër përpjekjeve në parashikimin e tyre bëjnë rrethana të pavolitshme në realizimin e qëllimeve të parapara.

Prandaj si detyrë kryesore e çdo bashkësie shoqërore është krijimi i ambientit të përshtatshëm për prosperitetin në të gjitha fushat jetësore. Parakusht esencial në arritjen e qëllimit të tillë është funksionimi harmonik në ekonominë kombëtare, që nënkupton krijimin e barazpeshës në ekonomi reale. Në ekono mall para ku ekonomia e tregut barazpeshën e arrin në mes të krijimit të kushteve të barabarta të ofertës dhe kërkesës së mallrave dhe shërbimeve. Mirëpo, këtë barazpeshë nuk mund ta arrijmë vetëm përmes faktorëve që shkaktajnë ofertën dhe kërkesën të cilët paraqiten si madhësi të varura dhe të cilat përcaktojnë vëllimin dhe përbërjen e tyre që e shprehim përmes indikatorëve vleror-çmimeve.

Marrë parasysh se çmimet janë shprehje nominale e vlerës, e cila bëhet përmes njësisë monetare që e shpreh nominalitetin e vlerës e cila matet në njësi para-ari, apo letër që mundëson qarkullimin dhe këmbimin e mallrave dhe shërbimeve. Mirëpo, vlerën e paraqesim si sasi të punës së nevojshme shoqërore që përmbajnë të mirat ekonomike, dhe këtë mund ta masim vetëm përmes punës së pigëzuar, materializuar në mënyrë sa më të pranueshme nga të gjithë subjektet e konomisë kombëtare. Kjo tregon se si masa vlerore na shërben dicka që në mënyrë ideale shpreh punën e dobishme shoqërore e këtë më së miri e prezenton malli i caktuar-mall ari, i cili posedon vlerën e përdorimit dhe vlerën e këmbimit dhe njëherit ngeli si përfaqësues reprezentativ i punës abstrakte te njëriut.

Duke u bazuar me këtë se ai shërben si mjet këmbimi, duke marr parasysh vetit natyrore dhe cilësinë e tij në dobishmërinë e plotësimin e nevojave atëhere këmbimi bëhet sipas cilësisë së përbashkët që përcakton vlerën e tyre në treg apo vlerën në qarkullim-këmbim. Së këndejmi me ndarjen e një malli si ekuivalent i përgjithshëm prej mallrave të tjerë miret karakteri i parasë. Me zhvillimin e

shoqërisë dhe proceset e veçuara të punës, ky mall fitojë funksionin shoqëror-ekonomik, sepse asnjë mall nuk mund të jetë para nga natyra, mirëpo ai funksion i është dhënë nga ana e shoqërisë.<sup>82</sup>

Me qenëse në ekonomin e tregut transakcionet në mes të ofertës dhe kërkesës shprehen përmes njësisë monetare dhe duke marrë në konsideratë se në mes tyre nuk qendron një ekuilibër i plotë, qartë rezulton se ecuria ekonomike cilësohet përmes vlerës së parasë, si mjet qarkullimi tregon se këtu bëhet fjalë për fuqinë blerëse të parasë.

Në literaturën ekonomike hasim mendime të shumta lidhur me ecuritë ekonomike, si dhe nevojat e rregullimit të sajë, të cilat mbështeten mbi sasinë e masës monetare. Mirëpo, fuqia blerëse e parasë nuk mund të përcaktohet nga sasia e sajë, apo sasia e mallrave por duhet vënë në raport me shumën e çmimeve të mallrave dhe shërbimeve në periudhën e caktuar. Këtë e theksojmë me qëllim që të kuptohet drejtë, kuptimi dhe përmbajtja shumë e rëndësishme e funksionit të parasë si masë vlerore dhe si masë e çmimeve. Së pari mendime të cilët mohojnë faktorët të cilat determinojnë karakteristikat e mallit, dhe qasen nga sasia e parave në qarkullim fitohet përshtypja e gabuar mbi pasojat e saja, të cilësuar si të veçuara nga proqesi qarkullues i pavarur, dhe krijon arsyeshmërin e paraqitjes të ideve reale mbi politiken monetare.

Me gjithëse edhe thjeshtëzimi i tepruar i parasë si masë monetare qarkulluese mund të sjellë edhe eliminimin e rëndësisë së parasë dhe ecurive monetare.

Prandaj, nëse thjeshtëzohet forma e parave si mall që shpreh procesin e këmbimit në mes të mallrave dhe parave, atëherë fjala bëhet për format e saja të cilat rrjedhin nga vetë procesi i qarkullimit. Në qarkullim gjinden mallra me çmime të ndryshme, andaj ai raport praktikisht tregon fuqinë blerëse të parave e cila nuk bënë të matet me sasinë e parave, por duhet të vihet në raport me shumën e mallrave dhe shërbimeve në periudhat e cekura kohore.

Vlenë të ceket, se edhe format e parave të cilat i përkasin nivelit më të lartë të procesit riprodhues bënë formën e parasë kredi. E meta e mendimeve mbi konceptet e të parëve duhet parasegjithash kërkuar në pamundësin e shpjegimit të drejtë mbi lidhmërinë në mes fazave të procesit riprodhues dhe mendimeve mbi politiken monetare kreditore, e kjo e dyta veqanarisht nuk qe në nivelin e duhur të arsyeshmërisë të rrjedhave ekonomike e me veqanti mospërcjellja adekvate e procesit të riprodhimit ku ecurit monetare nuk u përgjigjen arsyeshmërisë të zbatimit të treguesve makroekonomik që i shprehim përmes produktit kombëtar bruto dhe në bazë të tijë qart mund të tregohet ndërvashmëria në mes të variablave të rëndësishme të sektorit monetar dhe atijë real dhe njëherit mund të na tregon nivelin e pasigurisë. Më thjeshtë problemi kryesor nuk qendron vetëm në format dhe sasin monetare, por në raportin në mes të fazave në procesin riprodhues duke mos i rrespektuar propocionet e shpërndarjes në mënyrë të duhur dhe njëherit ndërvashmërinë në mes të tyre që qartë tregon nevojën aplikimit të masava dhe instrumenteve të politikës ffinanciare nga nan e organeve shtetërore. .

---

<sup>82</sup> Karl Marx: Kapitali, shtëpia botuese “Dituria”, faqe 98

Problemet e tilla organet e pushtetit mund ta rregullojnë përmes rregullimit të politikës monetare-kreditore që si detyrë e ka pushteti monetar-kreditor qendror e ky është akteri më i rëndësishëm në zbatueshmërinë e politikës monetare-kreditore si nënsistem i politikës ekonomike që së bashku me politiken fiskale mund të ndikon në stabilitetin dhe zhvillimin ekonomik.

Njëri nga qështjet me rëndësi primare që definimi i sasisë optimale-sasisë së masës monetare. Mirëpo, nga aspekti teorik sasia e nevojshme e parasë qendron në lidhshmërinë e përgjithshme të qarkullimit të parasë: sasia e parasë-masës monetare në funksion si mjet qarkullimi, e cila cakton shumën e çmimeve të mallrave në qarkullim dhe shpejtësia e qarkullimit të parave me të njejtin emër. Po të marrim tani shumën e përgjithshme të parave që gjinden në qarkullim gjatë një përmase të caktuar kohore na del se ajo duke qenë e mbështetur në shpejtësinë e qarkullimit dhe mënyrës së pagesave është e barabartë me shumën e çmimeve të mallrave që janë të destinuar në realizim, plus shumën e pagesave të cilave u është rritur afati i maturimit, minus pagesat që kompenzohen reciprokisht dhe më në fund minus numri i rrotullimeve në të cilat të njejtat para funksionojnë herë si mjet i qarkullimit e herë si mjet pagese.<sup>83</sup>

Konstatimi i tillë ka të bëjë me parat reale, pra si mallra të cilat qenë të lidhura me monedhen ari. Ndërsa sot kemi të bëjmë me suruvatet e parasë në qarkullim dhe përcaktuesit e masës monetare të nevojshme që bënë një proces shumë të ndërlikuar. Pra, sasia e nevojshme e masës monetare paraqitet si rezultat i faktorëve të prodhimit.

Mendime teorike tregojnë qartë se masa monetare ka rëndësinë në procesin e riprodhimit, si dhe vetë struktura e sajë, teknika e pagesave, organizimi i ekonomisë, dhe niveli i arritur i zhvillimit të institucioneve monetare, si dhe faktorët psikologjik. Mirëpo, të gjitha problemet dhe pasojat të cilat mund të na paraqiten parashtrajnë qëllim në veti për tu zgjedhur e veqmas në përcaktimin e fuqisë blerëse, eliminimin e inflacionit, deflacioni, problemin e kursit devizor, aprecionin dhe deprecionin, si dhe dukuritë lidhur me multiplikatorin kreditorë dhe monetar që kanë lidhmëri dhe ndërvashmëri në mes të masës monetare dhe procesit riprodhues.

Lidhur me zgjedhjen e problemeve monetare do të shërbehem me një shembull, po qe se banka qendrore emiton sasi ma të madhe të parave primare nga nevoja, rrespektivisht mbi nivelin e produktit kombëtar nominal, kjo sjellë rritjen e kërkesës në raport me ofertën e mallrave, që bënë rritjen e çmimeve dhe si pasojë e sajë sjellë uljen e vlerës së valutes kombëtare që vështirëson marrëdhënjet e qarkullimit me vendet tjera. Me qenëse vëllimi i prodhimitarisë së mallrave për shkaqe të shumta mund të sjellë edhe në rritjen e kërkesave atëhere kjo mundëson që ekonomia kombëtare-subjektet ekonomike prodhuese të realizojnë produktet e tyre dhe kështu do të tregojnë zvogëlimin e efikasitetit prodhues ku prodhuesit joefiqient mund t'i arrijnë të mbulojnë shpenzimet përmes çmimeve të larta. Anasjelltas me sasi ma të vogël të parave krahasuar me nevojat mund të shkaktohet pengesa e këmbimit të produkteve kombëtare e me këtë edhe prodhimi, punësimi etj.

---

<sup>83</sup> Karl Marx: Kapitali, shtëpia botuese "Dituria", faqe 80

## 2. Identiteti kryesor makroekonomik

Njëra nga detyrat më kryesore është që të bëhet analiza ekonomike për interakcionet në mes të sasive të parave, çmimeve dhe aktivitetit ekonomik. Kjo ka të bëjë me studimin e sjelljeve të ekonomisë si një tërësi që arsyeton nevojën e analizës sa më të hollësishme variabla makroekonomike të cilat mund ti masim përmes treguesve agregat si që është: produkti kombëtar i brendshëm, inflacioni, që shprehin ndryshimet në nivelin e përgjithshëm të çmimeve, normës së punësimit etj.

Mënyra e llogaritjes së produktit të brendshëm bruto, si tregues kryesor i cili përfaqëson vlerën e të gjitha mallrave dhe shërbimeve përfundimtare të prodhuara në vend brenda një periudhe të dhënë. Sipas fazave në të cilën kryhet matja ekzistojnë tri metoda të matjes së produktit kombëtar bruto:

- Në fazën e prodhimitarisë produkti kombëtar bruto llogaritet si shumë e produkteve përfundimtare, të çdo dege ose si shumë e vlerës së shtuar për çdo degë të ekonomisë kombatare.
- Në fazën e shpërndarjes produkti kombëtar bruto llogaritet si shumë e të ardhurave të faktorëve të prodhimit.
- Në fazën e konsumit produkti kombëtar bruto llogaritet në si shumë e shpenzimeve për konsum, investime, shpenzime qeveritare dhe eksport neto.

Si rregull, duke qenë se lëvizja e të njejtit aktivitet matet me faza të ndryshme, ato duhet të jenë të barabarta, por në varësi të teknikës së matjes së këtyre fazave, kushtëzon disa ndryshime që eliminohen duke bërë rregullimet përkatëse. Për shpjegimin e produktit të brendshëm bruto duhet të kemi parasysh shprehjen në nivele të çmimeve të periudhave të ndryshme kohore. Produkti kombëtar bruto nominal matet me vlerën e prodhimit në një periudhë kohore që tregon se prodhimi i mallrave të ndryshme fizikisht, si dhe çmimeve tregon se këtu përdorim çmimet e tanishme. Produkti kombëtar bruto real matë ndryshimin e prodhimit fizikë në ekonominë midis periudhave të ndryshme kohore duke vlerësuar të gjitha mallrat e prodhuara me çmimet nga viti bazë në vitin vijues. Megjithatë kuptimi i produktit kombëtar bruto përbën një cilësi arbitrare dhe pyetja bëhet se çdo rritje e produktit kombëtar bruto nuk do të thotë edhe zhvillim ekonomik psh. punësim më të madhë, zgjedhje të problemeve social ekonomin. Nëse i referohemi normës mesatare të rritjes së produktit kombëtar bruto nominal, dhe vëjmë re raportë me produktin bruto kombëtar real do të fitojmë deflatorin. Deflatori na tregon ndryshimet që ndodhen në mes të çmimeve të vitit bazë dhe të atyre korent, psh. të dhënat mbi normën mesatare të rritjes së produktit kombëtar në periudhën bazë dhe raportuese do të shofim sipas dinamikës të prezentuar si vijon:<sup>84</sup>

| Vitet | GDP | GDP | Deflatori i |
|-------|-----|-----|-------------|
|-------|-----|-----|-------------|

<sup>84</sup> Reudiger Berwbusch & Stanley Fisher: Makroekonomija, "Dituria" – Tiranë, fq. 27

|      | Nominal | Real | GDP |
|------|---------|------|-----|
| 1990 | 7.7     | 3.0  | 4.7 |
| 1991 | 8.8     | 1.6  | 7.2 |
| 1992 | 4.3     | 1.1  | 3.2 |
| 1993 | 0.3     | -0.5 | 0.8 |
| 1994 | 5.0     | 3.0  | 2.0 |
| 1995 | 3.9     | 2.4  | 1.5 |
| 1996 | 5.1     | 1.8  | 3.3 |
| 1997 | 5.4     | 2.7  | 2.7 |
| 1998 | 4.6     | 2.9  | 1.7 |
| 1999 | 4.6     | 2.1  | 2.5 |

*Tabela 1. Të dhënat mbi normën deflatore.*

Rritja e nivelit të çmimeve në ekonomi gjatë një perikudhe kohore tregon indeksin e çmimeve, në bazë të gjërë, që përdoret shpesh për të matur edhe inflacionin. Inflacioni në këtë rast e shprehë rritja e nivelit të çmimeve në ekonomin e një vendi. Ndërsa indeksi i çmimeve të konsumit mat koston e blerjes së një shporte të fiksuar mallrash dhe shërbimeve që përfaqësojnë blerjet e konsumatorëve, përmes së cilës vërtetohet fuqia blerëse e masës monetare.

Nëse ju referohemi çmimeve të mallrave dhe shërbimeve atëhere do të na ishte e kurtë se edhe interesi është çmim mbi paratë e huazuara. Përcaktimi dhe llogaritja e normave të interesit ka rëndësi teorike dhe praktike sepse përbën një ndër variablet më të përdorshme në botën monetare financiare. Për llogaritjen e normes së interesit fillimisht na është e dobishme njohja e konceptit të vlerës aktuale. Vlera aktuale përfaqëson shumën e vlerësimeve të sotme të të ardhurave të pritura në një kohë të ardhshme. Kjo është njëra nga shkaqët që shkakton ecurinë e masës monetare, rritja e masës monetare sjellë uljen e normës së interesit dhe anasjelltas. Sa më e ultë është norma e interesit subjektet ekonomike (familjet, ndërmarrjet) gjithnjë e më shumë është numri i tyre që huazojnë para për blerjen e mallrave, e kjo e bënë rritjen e kërkesave për konsum të gjërë dhe mjetet investuese që e mundëson angazhimin e faktorëve prodhues, punësim më të lartë dhe së fundi do të shënon rritjen e produktit kombëtar nominal. Nga ecurit e tilla shofim se rritja e sasisë në masën monetare bënë rritjen e produkteve kombëtare nominale e zvogëlimi do të sjellë ramje.

Me rëndësi është të shofim si produkti kombëtar nominal shprehet nëse rriten çmimet dhe rriten outputet. Përgjegja do të nvaret nga niveli i arritur i ekonomisë kombëtare. Më parë konstatuam se rritja e sasisë së masës monetare sjell rritjen e konsumit. Nëse ekonomia është në gjendje të ulët të punësimit të faktorëve prodhues, atëhere çmimet e outputeve do të shënojnë rritje, por nëse ekonomia shënon rritje të faktorëve prodhues, rritja e kërkesave si rrjedhojë e rritjes së parave do të sjellë rritjen e çmimeve. Por nga ana tjetër zvogëlimi i sasisë së parave kushtëzon uljen e çmimeve që njëherit tregon aftësin blerëse të parave ( $1/p$ ), dhe nëse niveli i çmimeve është i lartë, fuqia blerëse e parave është më e vogël dhe anasjelltas.

Vlera funksionale e parasë si cilësi e parave të sotme, nvaret prej shumës së çmimeve të mallrave, përkatësisht prej vlerës së punës së materializuar në produktet kombëtare.

### 3. Instrumentet financiare

Duke marrë parasysh rrethanat ekonomike dhe kohore, mendimet e shumëta teorike mbizotërojnë në arsyshmërinë në pengimin e emisionit të parave. Mirëpo është interesante se këto mendime shumë pak i kushtojnë kujdes mungesës monetare për qarkullim dhe pagasa, të cilat mund të krijohen nga rrethanat e qendrimeve, dhe masave të ndërmarrura nga pushteti monetar. Lidhur me emisionin primar dhe lejimin e kredive në sistemin bankar që më së miri dëshmon ekonomitë e vendeve në tranzicion dhe që bënë ramje relative të zhvillimit ekonomik dhe në mënyrë permanente tregon paaftësitë e shëndrimit të fondeve investive në ato të akumulimit. Tejkalimin e kësaj gjendje në ekonomin reale e shofim në mundësin e marrjes së kredive përmes instrumenteve financiare, obligacionit, akcionit, kambialit etj. të cilat subjektet ekonomike mund ti shfrytëzojnë si mjete pagese-sorogat të parave. Roli i tyre është i madhë, sepse kanë ndikim drejtpërsëdrejti në nivelin e pronësisë, si dhe në sjelljen e ecurive ekonomike të ekonomisë reale. Marëdhënjet në mes të huadhënësit dhe huamarrësit rregullohen përmes këtyre instrumenteve të cilat kanë karakteristika të ndryshme. Karakteristika kryesore lidhet me shkallën e ndryshme të rrishtit, që ato ofrojnë si për huamarrësit ashtu edhe për huadhënësit. Instrumente të ndryshme financiare përgjegjësisht dallohen njëri nga tjetri<sup>85</sup>:

- Nga preferenca për afate të ndryshme të maturimit që kanë huamarrësit dhe huadhënësit lidhur me nevojat e tyre.
- Nga lloji dhe nivelet e ndryshme të shpenzimeve dhe
- Nga shkalla e likuiditetit lidhur me shkallën e zhvillimit të tregut sekondar.

Në rregullimin e mardhënjeve në mes të huadhënësit dhe huamarrësit përdoren instrumentet e tilla financiare përmes së cilave jo vetëm që mundësohet qarkullimi relativisht i mirë, por njëherit bëhen edhe mjete për pagesa, që mundëson shëndrimin e mallrave në kredi dhe me eskontin e tyre paraqet shëndrimin e kredisë në para.

Monedha edhe në sistemet e hershme është paraqitur si sorogat apo zëvendësues i parave. Ajo shërbente si instrument i kreditimit dhe shëndrohet në një mjet qarkullues dhe si rrjedhim gjendja e qarkullimit tregonte nevojën gjithnjë më të madhe të parave. Sot ekonomija reale gjithnjë treogn nevojën për mjete monetare, siç e cekëm më parë shëndrimi i parave në depozitë, subjekteve ekonomike për mjete të tilla të deponuara ju lëshohet certifikata të cilat me rastin e blerjes së mallrave remitentët ndryshohen. Njëra nga instrumentet në formë të titullit është

---

<sup>85</sup> Andan Rovcanin: Upravljanje financijame, "Jordan Studio"-Sarajevo, fq. 33

kambiali që zakonisht përdoret në qarkullimin e mallrave me kredi. Për rolin e tij të madhë është vendosur që çdo gjë që ka formën, përmbajtjen, emërtimin, eskontin dhe pagesat e tijë duhet të jetë e rregulluar përmes ligjeve të posaqme. Kur bëhet fjalë për sasinë e mallit të blerë nga blerësit i cili nuk mund të paguajë, shitësi i tyre emërton një letër me vlerë, kambial për vlerën e mallit, që nënshkruhet nga ana e blerësit i cili merr përsipër detyrimin e pagesës në shumën e caktuar, në një datë dhe vend të caktuar. Shitësi kambialin e nënshkruar mund ta paraqes në një bankë dhe të arkëtojë shumën e parave të shënuar me një zbritje-skont.

Me zhvillimin e sistemit kreditor, kredia e marr në rrethanat e tanishme nuk është e nevojshme që të kthehet në para të gatshme, por mjafton që të bëhen regjistrimet në librat e huadhënësit, që është i njoftur si sistem i pagesave pa para të gatshme e që bëhet në bazë të urdhëresës-çekut të bankës.

Nga aspekti ekonomik çeku bën instrument për tërheqjen e parave të depozituar në llogarin bankare, dhe bënë transfer nga kjo llogari në favor të vet emituesit. Emituesi i saj jep urdhër me shkrim bankes në të cilën është llogaria depozituese që të bënë pagesat për personat e tretë. Çeku rrallë herë shkon në pagesë te banka, por përmes tyre në llogari të remitentit do të shenon rritje, apo zvogëlim të mjeteve në llogarin e trasantit, kjo bartje e mjeteve tregon se në bankë bëhet cirkulimi i pagesave të obligueshmërive.

Me qenëse ekonomija reale nuk mund të merr kredi drejtpërsëdrejti nga banka e nivelit të parë, praktika e vendeve të zhvilluara ekonomisht krijon sistemin e parave bankare, në të njejtën mënyrë si monedhën dhe kambialin. Sistemi i tillë i parave bankare e njofim si para llogarie, para kredije, sepse krijohet kryesisht me lejimin e kredive në llogari të huamarrësit. Në rrethanat bashkëkohore parat depozitare bëjnë pjesën kryesore në përmbushjen e detyrimeve të procesit qarkullues, ndërsa parat emisionare-rrespektivisht parat e gatshme shumë pak janë në përdorim, por në veçanti në rrethanat ku ekonomija shenon recesion depozituesit e mjeteve shprehin dëshirë se pagesat e tyre të bëhen në para të gatshme.

Parat depozitare bëjnë formën më kryesore të kreditimit. Mirëpo, në ekonominë e tregut pos parave transakcionare (parat e gatshme dhe depozitat sipas shiqimit) përfshin edhe depozitat e mjeteve të kursimit, pavarësisht afatizimit që bëjnë mjetet likvide ku bëjnë pjesë edhe mjetet e depozitave të afatizuara nga ana e sektorit jo bankar, si dhe letrat me vlerë afatshkurte të cilat sjellin kosto të fitimit. Pjesëmarrja e mjeteve transakcionale në mjetet likuide është varur nga norma e interesit. Aktiviteti financiar mund ta klasifikojmë në bazë të lartësisë dhe shpejtësisë së shëndrimit në mjete qarkulluese. Për ta vërtetuar shkallën e likuiditetit të aktivave financiare, shërbehem përmes tri kriterëve. Sa lehtë dhe shpejtë këto aktiva mund ti shesim, sa janë shpenzimet e shitjes së tyre dhe cili është stabiliteti dhe parashikimi i çmimeve të tyre në treg. Nëse shërbehem me kriterët duhet pasur parasysh shpenzimet transakcionare dhe përkundër faktit se sa lehtë mund të shëndrohet një aktiv financiar në para transakcionare. Këtë mund ta shofim përmes ndryshimit që shenon çmimet e furnizimit dhe çmimet shitëse, psh. nëse bëjmë konvertimi e një fletëobligacioni dhe akcioneve si mjete në aktiven financiare do të shofim se ato nuk kanë likuiditet të njejtë, obligacionet janë relativisht mjete likvide, kurse akcionet janë më pakë likuide. Po kësajë vetia e çmimeve të

akcioneve më shumë ndryshon dhe shpenzimet e këtyre transakcioneve financiare shenojnë rritje.

Arsyetimi i definimit të këtyre agregatëve monetar parasegjithash duhet mbështetur në sasinë e masës monetare në procesin e qarkullimit, nivelit depozitave-akumulimit, si dhe barazpeshën në mes të ofertës dhe kërkesës. Prandaj banka qendrore nga ky aspekt ka për detyrë që të kontrollojë depozitat, të cilat bëjnë parat transakcionale rrespektivisht parat primare dhe depozitat sipas shiqimit që është njëra nga bazat e piknisjes për lejimin e kredive afatshkurte. Mirëpo, edhe për mjetet e depozitave afatgjate-fondeve të cilat disponon ekonomija reale tek bankat mund të lejohet kredija duke marrë për bazë analizen e hollësishme të aktives financiare që është një ndër detyrat më të rëndësishme për menaxherët e bankës dhe kërkon një qasje të përcjelljes permanente-ditore rreth përbërjes të mjeteve depozitare e kjo nënkupton edhe aftësin e bankës në transformimin e mjeteve të afatizuara në mjetet qarkulluese. Shfrytëzimi i depozitave afatshkurtër për lejimin e kredive afatgjate dhe anasjelltas.

Mbështetur në konstatimet e mëparshme mund të konkludojmë se masën monetare e përcaktojnë faktorët ednogjen dhe sasia e masës monetare parasegjithash do të ketë ndikim në sektorin jobankar dhe definimin e kërkesave për para bankare. Në rrethana të kërkesës më të vogël për para bankare nga ana e sektorit jo bankar do të kushtëzojmë arsyshmërinë e rikutimit të aktives financiare në favor të rritjes agregatëve tjerë monetar që bënë mundësin për investime dhe shkallë të zhvillimit ekonomik. Nëse marrim për bazë këtë konstatim se çka e përbën masën monetare dhe si përfundim marrim rritjen e likuditetit makroekonomik në masë monetare do të përfshijmë të gjithë agregatët të cilët drejtëpërsëdrejti, apo në mënyrë sa më adekuate mund t'i modifikojmë si mjete për pagesa, atëherë është evidente se si ndërmjetës mund të shfrytëzohet edhe letrat me vlerë përmes këtyre parave komerciale mundësohet procesi mes kreditues.

Rëndësia e aktivitetit kreditor, jo vetëm për banka por edhe institucionet financiare (fondi pensionist, fondet e sigurisë, fondet e shëndetësisë) ndikojnë në rregullimin e tregut financiar pikërisht përmes emitimit të letrave me vlerë vetanake. Fondi pensional dhe kompanit e sigurimeve emitojnë kontrata për pagesat e ardhshme në rrethanat specifike. Fondet e përbashkëta mund të emitojnë akcionet dhe në këtë mënyrë të ndikojë në përbërjen e aktives financiare-pra portofolit. Qëllimi i tyre është të krijojnë profit.

Rëndësia e aktivitetit kreditor, jo vetëm të bankave, por edhe institucioneve ndërmjetësuese në formimin e profikut kombëtar nominal u theksua edhe nga Gurley Shaë<sup>86</sup> “Roli i kredisë i lejuar në bazë të mjeteve të kursimit, rrespektivisht të ardhurave të pasqepzuara që bënë akumulimi nëse nuk lejohet kredija mjetet e tilla do të jenë për një moment si mjete të humbura për subjektet ekonomike të cilat nuk arrijnë nivelin e duhur të mjeteve dhe mbivlerës së krijuar. Lejimi i kredive në bazë të kursimeve afatgjate, ndikon në rritjen e mundësisë për lejimin e kredive investuese që mundësojnë rritjen e produktit kombëtarë këtë më së miri e shpjegon

---

<sup>86</sup> Milutin Ciric: Primarno trziste kapitala, “Zbornik”-Novisad 1997, fq. 20

P. A. Samuelson<sup>87</sup> “shoqëritë progresive një pjesë të konsumit vijues e sakrifikojnë me qëllim të akumulimit të kapitalit të ri, i cili do të risë prodhimin e ardhshëm. Prandaj, mund të konstatojmë se kursimi është parakusht për krijimin e mjeteve të pamjaftueshme për funksionimin e mekanizmit në tregun financiar. Roli i të cilave shifet në krijimin e kushteve optimale të rrjedhës së mjeteve financiare, prej atyre që disponojmë tek ata të cilët dëshirojnë dhe mund t’i aktivizojnë në mënyrë të pavarur në financimin e projekteve prodhuese dhe e sigurojnë nivelin e likuiditetit të tyre”. Tregjet e tilla tek ne nuk funksionojnë për shkaqe të akumulimit të pamjaftueshëm të mjeteve financiare dhe mungesës të aprovimit të ligjeve specifike për këtë fushë të veprimtarisë, gjendjes politike, por edhe mënyra se mekanizmi i transakcioneve kryesisht bëhen përmes parave të gatshme. Andaj mos shfrytëzimi i letrave me vlerë nga ana e ekonomisë reale si formë e laveddishme do të shkakton edhe mëturje pasoja negative: rritja e sasisë monetare të pashfrytëzuar në sektorin e popullsisë, ngadalsimin e qarkullimit, si dhe nevojën e huamarrjes së kredive nga burimet tjera që mund të krijojnë një qregullim të rritjes të sasisë masës monetare ka krahasuar me produktin shoqëror nominal e që mund të vjen edhe shprehja e inflacionit.

#### **4. Procesi i moskreditimit**

Nga viti 1959 në raportin e komitetit Radiceff u cekë, se punët bankare dhe aktivat financiare të tjera nuk mund të bëhet përkufizim në rritjen e masës monetare. Në masën monetare bëjnë pjesë të gjithë agregatët që kanë cilësinë monetare, pavarësisht veprimeve që duhet ndërmar lidhur me formën e sajë. Mbështetur në konstatimin e raportit mund të ceket se marrëdhënjet në mes të sektorit jobankar mund të rregullohen përmes procesit të kreditimit. Ky proces mund të definohet edhe si provongim i përkohshëm i pagesave që bëhet në bazë të formave të parave komerciale, por i cili nuk mund të definohet si mjet i pagesës përfundimtar por shërben në transakcionet mbi ekonominë në vendet bashkëkohore i cili ka të metat se ky lloj agregati monetar mund të shërben vetëm në ekonominë kombëtare.

Me qenëse procesi i moskreditimit mund të kushtëzojë rritjen e masës monetare, duke e bërë eskontimin e letrave me vlerë tek bankat dhe përmes procesit të rieskontimit të tyre në bankën qendrore do të bënë të mundshëm rritjen e potencialeve kreditore afatshkurte për dhënjen e kredive të subjekteve të ekonomisë reale. Banka qendrore në këtë rast bëjnë rritjen e parave primare. Bëhet pyetja sa është mundësia e bankës qendrore që të ndikojë në avogëlimin e këtij procesi? Përgjigja do të ishte, se këtë mund ta bëjë në mënyrë indirekte, së pari duke rritur vëllimin e parave primare në varshmëri të zbatimit të politikës financiare dhe përmes të ashtuquajturit mekanizmit të çmimeve-të normës diskonte, si dhe instrumenteve kvantitative-multiplikatorit kreditor monetar si dy faktorë kryesorë në rregullimin e masës monetare. Mirëpo si instrument i kontrollit mjet edhe multiplikatori monetar, bilansi i konsoliduar i bankave, transakcionet devizore me vende të tjera. Mënyra që banka qendrore e zbaton lidhur me rritjen e masës

---

<sup>87</sup> P. A. Samuelson: Ekonomia, “Savremena Administracija”-Beograd, fq. 226

monetare, si dhe funksionimi i tregjeve të lira të instrumenteve monetare mundëson shkallën e shfrytëzimit të parave në zhvillimin e prodhimit angazhimin e faktorëve prodhues e kështu me radhë.

Zhvillimi i tregjeve të lira, te letrave me vlerë daton që nga kriza ekonomike e viteve 30, atëherë kur shkaqet dolën nga thellimi i mungesës të realizimit të mbi produkteve, të cilat ngelen të perealizueshme dhe njëherit edhe deficitit buxhetor të shteteve të zhvilluara. Për eliminimin e shkaqefë të tilla u perdoren letrat me vlerë afatshkurte, përmes të cilave u bë mobilizimi i mjeteve të lira nga ndërmarrësit privat të cilët nuk qe në gjendje qe mjetet e tilla ti angazhojnë në procesin prodhues për shkak të pamundësisë të plasmanit të produkteve të reja.

Në vendet e zhvilluara banka qendrore me autoritetin e sajë bënë blerjen dhe shitjen e letrave me vlerë (bonat e thesarit, akcentet financiare, letrat e sigurimeve afatshkurtë) që është njëra nga detyrat dhe përgjegjësitë e rregullimit të politikës financiare në vend. Vendimet e marrura bazohen në interakcionet në mes të variablëve të rëndësishme që përbëjnë shume elemente të pasigurta. Andaj, me zbatimin e politikës financiare duhet të ketë parasysh politikën zhvillimore duke mbështetur në normën e rritjes dhe zhvillimit duke rrespektuar arsyeshmërinë e zbutjes të punësimit, politikës së çmimeve, bilansit të pagesave me vendet tjera. Nëse në ekonominë kombëtare kërkesat efektive janë të larta që sjellin ngritjen e çmimeve, banka qendrore duhet të zbatojë politikën restriktive me qëllim të zvogëlimit të masës monetare, kështu që të forcojë fuqin blerëse të parasë psh. pushteti monetar mund të lëshojë në shitje bonat e thesarit, përmes të cilave do të mobilizon mjetet financiare. Mirëpo, nga ana e pushtetit financiar mund të ndodhë edhe shitja e letrave me vlerë siç është rasti i Euro-Bound në Shqipëri lidhur me sigurimin e mjeteve për pagesat e huave të marura nga institucionet kombëtare monetare që kanë normë të lartë të interesit dhe me synim që të bëhet servisimi i tyre në kushte më të favorshme, pra me normë të interesit më të ultë që njëherit tregon edhe mundësin e reduktimit të deficitit buxhetor, duke pas për bazë edhe masat tjera që zbaton pushteti lidhur me përcaktimin e obligimeve që dalin nga politika fiskale. Banka qendrore në zbatimin e politikës monetare mund të paraqet limite të caktuara të cilat nuk bënë të tejkalohen, duke pas për bazë thesarin i cili nuk është në gjendje që të arsyetojë rritjen e mjeteve buxhetore përmes lejimit të kredisë. Problemi kryesor qendron në fuqin blerëse të njesisë monetare që thjeshtë e varur nga produkti kombëtar i vendit. Problemet e tilla mund të sjellin edhe disharmoni në lejimin e kredive nga ana e bankave të biznesit të cilat për shkaqe të arritjes të fitimit mos rrespektojmë në mënyrë adekvate aktivat financiare që mund ta tronditin tërë sistemin bankar të vendit. Mirëpo, mbulesat e kërkesave agregate siç është shpenzimet qeveritare të cilat kanë një rritje të lartë tregojnë qartë deficitet buxhetore të cilat sjellin kriza të thella siç është rasti në Greqi, e kjo mund të reflektohet në tërë Eurozonën, si dhe në vendet të cilat kanë transaksione ekonomike në bilansin tregëtar, apo uljes së remitencave që sjellshin punëtorët nga ky vend. E kjo bënë njëren nga uljet e kursimeve dhe ramja e depozitave që sjellë vazhdimisht ramjen e krediteve. Ky është një tregues i cili e vërteton proverben e lashtë “çka ndodhë sot tek kojshija, nesër mund të ndodhë tëk shtëpia”.

### **Përfundimi**

Si përfundim të këtijë studimi, masës monetare, çmimeve dhe aktivitetit ekonomik është i rëndësishëm dhe sjellja e kënaqësisë, sepse qështjet që i trajtuam ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në marrjen e vendimeve mbi zhvillimin ekonomik, e kjo njëherit bënë një mundësi të kuptimit të qartë të fenomeneve ekonomike që janë kaq të reja në këtë fazë të tranzicionit.

### **Referencat**

1. Andan Rovcanin: Upravljanje financijame, “Jordan Studio”-Sarajevo
2. Milutin Ciric: Primarno trziste kapitala, “Zbornik”-Novisad 1997
3. P. A. Samuelson: Ekonomija, “Savremena Administracija”-Beograd,
4. Reudiger Berwbusch & Stanley Fisher: Makroekonomija, “Dituria” – Tiranë